



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.23/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtares e lartë ligjore, Antigona Murati duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së banerëve në shtylla publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 02.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, kështu që subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi, dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,000.00 (tremijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 31.05.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkangjitur si dëshmi fotografën e printuar nga vendi i ngjarjes, si dhe një CD. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 31.05.2017, rreth orës 07:00, në rrugën Adem Jashari në Prizren, në afërsi të Kuvendit Komunal dhe zyrës së Kryetarit të Komunës (e njohur si Shtëpia e Bardhë), monitoruesit e tyre ka hasur në postere të kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) të ngjitur në një shtyllë publike dhe në drunj të qytetit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se subjekti politik KDTP ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuara si dhe një CD me dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik KDTP të datës 01.05.2017, ka theksuar se posterat janë të vendosura në shtylla dhe drunjë publike ashtu siç kanë vepruar edhe subjektet tjera politike dhe shihet qartë se sipas ankesës janë pllakatat personale të kandidatëve nga KDTP. Subjekti politik KDTP në përgjigjen në ankesë ka theksuar se kanë vepruar sipas nenit 3, të Rregullës 13/2013, dhe vullnetarisht çdo herë largojnë të gjitha posterat menjëherë pas ditës së zgjedhjeve. Subjekti politik KDTP në përgjigjen e tyre kanë deklaruar se do ta pranojnë dhe zbatojnë çdo vendim të PZAP-it në lidhje me këtë ankesë. Me propozim që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) janë të vendosura në shtylla publike dhe drunjë të qytetit, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjohës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Si rrethanë mori se subjekti politik KDTP, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterat e kandidatëve për deputet janë të vendosur në shtylla publike si dhe në drunjë mbi rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik KDTP ia dha mundësinë për tu përgjigjur dhe bërë përmisimin e shkeljes mirëpo në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre ata kanë mohuar se kanë bërë shkelje dhe nuk kanë marrë asnjë veprim për të tërhequr posterat në vendin e palejuar.

PZAP-i, pasi vlerësoi pretendimet ankimore sipas kriterëve të përcaktuara më lart, konstatoi se nga ana e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), është shkelur neni 33, pika b) të LZP-së, pasi që nga provat e ofruara shihet qartë se banerat e kandidatëve të subjektit të tij janë vendosur në shtylla publike dhe në drunjtë e qytetit, si dhe duke marrë parasysh se subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi, nuk ka bërë asnjë veprim për ta përmirësuar shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike respektivisht largimin e banerave edhe pse është urdhëruar nga PZAP-i, me parashtrësën e datës 31.05.2017, që ta përmirëson shkeljen e theksuar më lart.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 3 par.2 të Rregullës Nr.01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it dhe kuptim të nenit 118 par. 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.23/2017 më datën 02.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri**



Kwshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.